

Njoftim për aplikim për licencim

Në mbledhjen e tij të datës 19.07.2023, Bordi i ERE-s vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “ALB SUN ENERGY” shpk në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 MW, me vendndodhje në fshatin Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, Qarku Fier.

Ftohen palët e interesuara të shprehin opinionet dhe komentet e tyre me shkrim nga data 20.07.2023 deri në datën 29.07.2023, pranë zyrave të ERE-s, në adresën: Bulevardi “Bajram Curri”, Rruga “Viktor Eftimiu”, 1023, Tiranë, ose në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al.